

2 Studimi që qartëson ashpërsimin e pabarazisë Korporatat zhvasin edhe gjatë pandemisë

3 Nisma 99% e socialistëve të rinj Taksim më i drejtë i super të pasurve

4 Përfshirja e diasporës në politikat ndërshtetërore Pritshmëritë konkrete nga Zvicra e Kosova

Nr. 5 | Shtator 2021 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

Demonstrata e 18 shtatorit: Durt lagr nga pensionet e grave

Kundër diskriminimit edhe me të madh të grave!



Përpjekja për të të përkeqësuar pensionin e shtyllës së parë kryesore të sigurimeve shoqërore AHV/AVS do të has në kundërshti

Gratë edhe më tej marrin rreth një të tretat (1/3) më pak pension se sa burrat. Megjithatë parlamenti donë të ngritë moshën e pensionit për gratë në 65 vjet. Kështu gratë duhet të paguajnë reformën e AHV/AVS. Rritja e moshës së pensionimit për gratë do të thotë se ato duhet të punojnë më gjatë dhe të marrin pension më të ulët. Kjo është e papranueshme! Një reforme të AHV/AVS në kurriz të grave e kundërshtojnë sindikatat bashkë me organizatat feministe përmes një demonstrata kombëtare me 18 shtator 2021 në Bernë.

Marília Mendes

Arsyet pse pensionet e grave janë më të ulëta

Pensionet më të ulëta të grave pasqyrojnë situatën e tyre në marrëdhëniet e punës: Gratë ndërpresin më shpesh marrëdhënien e tyre të punës dhe punojnë më shumë me orar të pjesshëm. Të dyja në radhët të parë, për të kryer punët e shtëpisë dhe për të marrë përsipër kujdesin familjar. Edhe pabarazia mes pagave të grave dhe burrave kontribuon në pensione më të ulëta tek gratë. Gratë aktualisht fitojnë rreth 19% më pak se kolegët e tyre meshkuj. Në përputhje me këtë pensionet e tyre në pleqëri do të jenë më të vogla. Të gjitha këtyre duhet shtuar edhe pabarazinë e madhe e pensioneve të fondit të pensioneve.

Pensionet e AHV/AVS kundrejt fondit të pensionit

AHV/AVS është përkujdesje korrekte e pleqërisë. Pas grevës së parët të grave më 1991 ka fuqizuar masat e caktuara të barazisë, për këtë arsye tani pensionet e AHV/AVS të grave dhe burrave janë përafërsisht të njëjta. Mirëpo pensionet e AHV/AVS janë të ulëta. Ndryshe nga që parash kushtetuta që gati 50 vite, askush nuk arrin që të mbulojë ne-

Të gjithë në Bernë: Jo reformës së pensioneve në kurriz të grave

13h 30 Schützenmatte: Vendtakimi dhe demonstrata

15h 00 Bundesplatz: Manifestimi përmbyllës dhe koncertet

vojat jetësore vetëm me pensionin e shtyllës së parë AHV/AVS.

Shtylla e dytë (d.m.th Fondi Pensional / FP) për shumë gra është vetëm një shtesë e dobët: pensionet mesatare të FP të grave është vetëm rreth gjysmës së lartësisë se ato të burrave.

Dhe kjo qëndron vetëm nëse një grua merr pension fare: edhe më tej gati një e treta e grave nuk merr fare pension nga shtylla e dytë.

Gjysma e grave, të cilat janë pensionuar me 2018, marrin një pension të FP nën 1165 franga në muaj. Në sektorët tipik të grave pensionet e FP zakonisht janë mes 500 e 800 franga-ve për muaj: edhe këto nuk mjaftojnë për të jetuar.

Diskriminimi edhe në moshën e pensionit


Andaj kjo bënë që dyfishi i grave të marrin të ardhura suplementare, për të përballuar kostot jetësore. Diskri-

minimi i grave, që ishte i pranishëm qysh në jetën profesionale, vazhdon kështu edhe në moshën e pensionit. Kjo edhe pse ato kujdesen për fëmijët dhe familjarët, krahas kësaj janë në marrëdhënie pune – dhe në moshën e pensionimit marrin përsipër pjesën kryesore të përkujdesjes për nipërit e mbesat.

Dhe tani, në vend se të përmirësohen pensionet e ulëta të grave, parlamenti përmes rritje së moshës së pensionimit për gratë bënë pikërisht të kundërtën: një reduktim pensionesh në kurriz të grave. Qysh në sesionin e vjeshtës së tanishme parlamenti përmes "AHV/AVS 21" donë të aprovon një reformë në kurriz të grave.

Për pensione më të mira të grave

Gratë kanë nevojë për një përmirësim urgjent e jo reduktim të pensione-ve të tyre. Andaj sindikatat kanë iniciuar nismën AHV/AVSx13, për një pension të 13-të të AHV/AVS,



e cila do të duhej ti përmirësohet të gjitha pensionet (Informacione të mëtejme: <https://www.ahvx13.ch/?src=frauenrenten>). Andaj ne kundërshtojmë reformën +”AHV/AVS 21”, e cila faktikisht domethënë reduktim të pensioneve të grave.

Prandaj ne do të dalim në rrugë me 18 shtator dhe do të vejmë një shenjë fuqishme para pallatit federal.

Më shumë informacione:

www.unia.ch/de/aktuell/events/detail/a/18287

unia.ch/fr/actualites/evenements/detail/a/18288

unia.ch/it/attualita/eventi/particolare/a/18296

Editorial



Fitimet privati, borxhet shtetit

Deri me 2030 do të mungojnë 65000 personel kujdesi. Një numër tmerrësisht i madh kur kemi parasysh se sa thelbësorë është i personeli shëndetësor për shoqërinë. Jo vetëm në kohë pandemie, por veçanërisht edhe gjatë saj. Pasi qysh tani kujdestar*et janë duke punuar në limite. Me pagat e këqija, orar shtresues të punës. Andaj nuk është për tu quditur se shumë prej tyre nga frustrimi, zhgënjim dhe drenazhimi hedhin peshqirin dhe i kthejnë shpinën profesionit të kujdestarisë. Dhe ç' ka bënë politika BORGJEZE dhe propaganduesit e përjetshëm të «tregut që rregullon gjithçka». Mundësisht të mos ndërmerret asgjë. Kushtet e punës janë ekskluzivisht çështje e punëmarrësve dhe punëdhënësve dhe shteti duhet të mos përzihet. Mirëpo, kur kantonet tek kjo çështje kaq e rëndësishme nuk mund të siguroj kualitet të kujdesit, atëherë vuan përkujdesja e përgjithshme. Të pasurit mund ta blejnë shëndetin, ne të gjithë jemi të varur nga shërbimet e mira. Andaj me 18 nëntor të votojmë me PO nismën e kujdesit.

Po, ata – zvatësit i kanë punët mirë. Ata edhe gjatë vitit të koronës kanë arkëtuar dhe janë pasuruar paturpshëm. Fale edhe ndihmës shtetërore. Gjatë pandemisë përmes punës me kohë të shkurtuar kanë mbajtur ulur koston. Me fitimet kanë shpërndarë bonuse dhe dividendë të majme. Migros-i përfitoi nga shteti 71 miliona. Në të njëjtin vit e katërfishoi fitimin. Një pasqyrë të ngjashme kemi tek të 14 korporatat e Zvicrës.

Bilanci i pikëlluar i studimit të ri të Unia: Menaxherët dhe aksionarët arkëtojnë, përdërisa punëmarrësit në punë me orar të shkurtuar duhet të heqin dorë nga pjesë të pagave të tyre edhe ashtu të dobëta.

Hilmi Gashi

News

Unia Region Berner Oberland

Forcoje ekipin tonë për zhvillimin e anëtarësisë në vendqëndrimin Thun menjëherë apo sipas marrëveshjes **Sindikalist* e në shërbim të jashtëm 80-100% Ti kontribuon dukshëm**

Me dinamizëm dhe bindje të përfitosh e rekrutosh anëtarë të rinj për Unia. Së bashku me anëtarët ti angazhohesh për kushte më të mira pune nëpër ndërmarrje dhe në të gjithë sektorin. Tek fushatat dhe aksionet tona të përbashkëta ti je pjesë qendrore.

Ti bie me veti

- Arsimim të përfunduar profesional apo studim dhe përvojë në prurje

- Aftësi të shkëlqyera komunikimi me një paraqitje bindëse në rekrutim të anëtarëve

- Identifikim i lartë me vlerat e sindikatës Unia

- Njohuri shumë të mira të gjermanishtes dhe shqipes apo portugalishtes

- Lejen e vozitjes të kategorisë B

Dërgo dosjen tënde complete të aplikimit përmes E-mail në:

Bern.Bewerbung@unia.ch.

Informata të më tejme në unia.ch -> Jobs.

Përkujdesa profesionale: Të paguash më shumë – të marrësh më pak

Komisioni parlamentar nacional (SGK-N/CSSS) fundos kompromisin e ekuilibruar të partnerëve social për përkujdesjen profesionale (BVG/LPP) dhe në vend të kësaj vendos zbritjen e pensioneve deri në 12 % për të punësuarit si dhe lehtësim të gjerë për ata që fitojnë më shumë. Shanset për të reduktuar shpejtë hendekun e pensioneve të grave, u hoq nga tryeza nga komisioni jorealit. Përfundimi është se «modeli Courten» nënkupton kosto shtesë masive për personat e siguruar me paga të ulëta dhe me të ardhura normale. Pas 15 vitesh zbritje masive të pensioneve dhe në të njëjtën kohë rritja e përhershme e kontributeve të BVG/LPP nënkupton që kjo reformë e BVG/LPP-së të dështojë, nëse komisioni nuk kthehet në vendimin paraprak. Të siguruarit nuk do të paguajnë më shumë duke qëndruar duarkryq për më pak pensione. Pasi që qysh sot pensionet nuk mjaftojnë për jetesë për gjithnjë më shumë njerëz.

Rregullore e re e punës në ndërtimtarë

Në Rregullore e re të punës në ndërtimtarë (BauAV/OTConst) janë përcaktuar masat e nevojshme për mbrojtje dhe siguri të punëmarrësve nëpër kantiere ndërtimi. Ajo tanimë është përpunuar dhe punëtorëve të ndërtimtarisë u bie përmirësime të rëndësishme. Unia ka qenë pjesëmarrëse në përpunim. Sindikatat kanë adresuar suksesshëm preokupime e shqetësime të ndryshme. Posaçërisht është arritur të forcohet mbrojtja e shëndetit. Megjithatë të pazgjidhura kanë mbetur probleme të caktuara. Unia do të angazhohet posaçërisht që të futen kritere të qarta sa i përket ndalimit të punës gjatë rrezikut shkaku i motit të keq dhe vapa ekstreme.

Gjithashtu e rëndësishme për punëmarrësit: Po martesës për të gjithë!

Pabarazia juridike favorizon diskriminimin, këtë e dinë tanimë shumë mirë punëmarrësit LGBTIQ. Prandaj futja e vonuar e martesës për të gjithë në Zvicër është gjithashtu një hap i rëndësishëm për më shumë barazi në botën e punës. Sindikatat angazhohen me të gjitha forcat për një PO me 26 shtator. Një JO në të kundërtën Zvicër në aspektin e politikave të barazisë do ta kthente mbrapa për dekada.

Studimi i Unia: Sa paturpshëm pasurohen Roche, UBS & Co

Kundër vjedhjes së pagave edhe vet korona është e pafuqishme

Pandemia shkakton harxhime në lartësi miliardash. Megjithatë, korporatat zvicerane vazhdojnë të zhvatin edhe më tej.

Ralph Hug, gazeta work 2 korrik 2021 (e shkurtuar)

Kthjellim: Në korporatat e mëdha zvicerane menaxherët dhe pronarët zhvatin më tej, thuaja se nuk kishim fare koronavirusin me dëme në lartësi miliardash. Këtë Unia ka mundur ta dëshmoi me qartësinë e qelqit në studimin e saj të ri mbi diferencën e pagave nga ekonomistja Noémie Zurlinder. Bile korona e ka ashpërsuar pabarazinë mes kapitalit dhe punës. Më poshtë gjeni shifrat më të rëndësishme:

■ Me 2020 aksionaret e aksionarët në ndërmarrjet e analizuara kanë arkëtuar gjithsejtë 60,6 miliarda franga, njëjtë shumë si në vitin paraprak. Paratë vijnë nga dividendët dhe riblerja e aksioneve. Tek dividendët shkuan deri edhe 5% më shumë para tek pronarët se sa vitin paraprak.

■ Hendeku i thellë mes pagave më të larta dhe atyre me të ulëta nuk është zvogëluar në thelb. Kalëruesi i parë i vjedhjes së pagave në etazhin e qilimave rishtas është korporata farmacistë Roche e Bazelit me në krye CEO Severin Schwan. Ai ka zënë vendin e parë me pagën më të lartë vjetore në Zvicër me 14,6 milionë franga. Këto bëjnë më shumë se sa 1 milion franga në muaj.

■ Vetëm 32% e vlerës së shtuar shkuan për punonjësit, ndërsa 68% shkuan për menaxherët dhe aksionarët.

Përfitim nga ndihma shtetërore

Në mënyrë skandaloze shumë nga kompanitë e ekzaminuara kanë marrë kompensim gjatë pandemisë për punë me kohë të shkurtuar, pra ndihmë shtetërore për paga. Kjo u ka mundësuar atyre, të mbajnë fitimet e larta e bile edhe ti rrisin ato. Kështu Migros-i vitin e kaluar ka marrë 71 milionë franga si kompensim për punë me kohë të shkurtuar, duke rriti fitimin në të njëjtën kohë për katër herë. Gjithsejtë 14 korporata në vitin 2020 shkaku i pandemisë kanë përfitur nga ndihma shtetërore – ndërsa pa asnjë mëdyshje u kanë shpërndarë miliona të tërë dividendëve.

Nisma e kujdesit: për një kujdes më të mirë

«Për të qenë ne pranë, kur ti ke nevojë për ne»

Popullata sa vjen e vjetrohët dhe ka nevojë për më shumë përkujdesje. Mirëpo në Zvicër mungon personeli kujdestar: Deri në vitin 2030 sipas vlerësimeve do të mungojnë së paku 65000 kujdestar. Qysh tani kushtet e punës janë të padurueshme. Iniciativa popullore «për një kujdes të fortë» (Nisma e kujdesit) donë ta ndryshojë këtë dhe një sistem shëndetësor, që respekton punëmarrësit!

Marie Saulnier Bloch

Me 18 nëntor populli do të voton për iniciativën e nisur të Shoqatës Profesionale Zvicerane të grave e burrave kujdestarë (SBK), përmes së cilës do të duhet të sigurohej edhe në të ardhmen kualiteti i kujdesit në Zvicër.

Kolegët tanë nga sektori i kujdesit qysh para pandemisë kanë qenë të rraskapitur. Mungesë e kujdestarëve të arsimuar, mbingarkesat, personel të pakët, pagesë e ulët, shkarkime, pakënaqësi e mungesë perspektive. Megjithatë ishin në këmbë e të palodhshëm. Për ne, të dashurit tanë, për kolegët tanë. Të tregojmë solidaritetin tonë dhe aftësinë tonë organizative: të mobilizohemi për një PO të qartë me 18 nëntor.

Merr pjesë! Bëhu ambasador* e i/e kujdesit!

A donë ta ndihmosh nismën e kujdesit që të jetë e suksesshme? Pra bëhu ambasador* e për nismën e kujdesit dhe bindi koleg*et tua, për të votuar me PO. Natyrisht me mbështetjen tonë!

Këtë bënë një ambasador* e për nismën e kujdesit

- Si ambasador* e kujdesit në shtëpinë tënde të pleqve dhe kujdesit bindi koleg*et tua përmes bisedave personale dhe me ndihmën e materialit tonë mbështetës mbi nismën e kujdesit.
- Ti nga ne do të marrësh një kuti të nismës me mjete ndihmëse si argumentet dhe udhërrëfyesin e bisedës për shtëpi pleqsh si dhe Fletëpalosje, pllakate, botona etj.
- Ti mund të marrësh pjesë në trajnime dhe të mësosh se si mund tu qasësh koleg*eve tua.

Zhvatësit më të mëdhenj të vitit 2020



LISTA JOKREDIBILE: Këta burra në vitin 2020 edhe përkundër koronës kanë nxjerrë përfitim të majme. (Montazhi: work)

Ashpërsimi i pabarazive

Bilanci pikëllues i studimit të ri të Unia: Kriza e koronës ka ashpërsuar pabarazitë ekzistuese. Menaxherët e mëdhenj dhe aksionarët arkëtuan edhe më tej, ndërsa punëmarrësit në punë me kohë të shkurtuar është dashur të heqin dorë nga pagat e tyre edhe ashtu të dobëta.



Çka pretendojnë kundërshtarët e nismës?

Edhe pse mungesa e personelit është një problem i pranuar, kundërshtarët e nismës janë të mendimit, që kushtet e punës për personelin e përkujdesjes janë vetëm çështje e punëdhënësit dhe jo edhe e shtetit.

Si duhet reaguari ne?

Sektori i kujdesit është esencial. Secili nga ne është i prekur nga kjo. Shëndeti publik dhe punëmarrësit nuk guxojnë të jenë çështje e rentabilitetit dhe spekulimeve.

Asgjë nuk ndodh vetvetiu: Kantonet dhe federata duhet të investojnë më shumë në arsimim, të përmirësojnë kushtet e punës dhe të rrisin kompetencat e personelit kujdestar përmes një trajnimi e arsimimi të mëtejshëm. Tatimet tona të përdoren për mbulimin e nevojave tona. Ne duhet ti japim fund presionit në vendin e punës. Vihen në lojë shumë jeta. Sot dhe nesër.

Mobilizo koleg*et që ke, pavarësisht nga fusha jonë profesionale: unia.ch/de/kampagnen/pflegeinitiative-ja. Secila votë vlen e numërohet: PO për Nismën dhe JO kundërpropozimit!

Nisma 99% e socialistëve të rinj (Juso)

Taksimi i drejtë i super të pasurve

Popullata votuese e Zvicrës ka një shans të mundësojë një ndarje më të drejtë të pasurisë. Borgjezëve dhe përfaqësuesve të ekonomisë kjo nuk u përshtatet fare. Me argumente të çuditshme ata përpiqen të parandalojnë taksimin e drejtë të super të pasurve.

Noémie Zurlinden


Me 26 shtator Zvicra voton mbi nismën 99% të socialistëve të rinj (Juso). Nisma kërkon, që të ardhurat kapitale të taksohen 1,5 herë më lartë se sa të ardhurat e punës. Për të ardhurat kapitale, p.sh. dividendët, fitimet e aksioneve dhe interesat e kamatës, pronarëve të kapitalit (1% i më të pasurve) nuk u nevojitet të lëvizin as gishtin. Punëmarrësve (99% të tjerë) u duhet të punojnë rëndë për të fituar pagën e tyre. Një taksim më i lartë e të ardhurave kapitale siç shihet është korrekte.

Përparësitë tatimore për të ardhurat kapitale

Të ardhurat nga puna taksohen 100%. Jo kështu ndodh me të ardhurat kapitale: Në vitet e fundit ka pasur lehtësira të panumërta tatimore. Dividendët, fjala bie taksohen me së larti me 70%. Pra, të pasurit përfitojnë dyfish: Ata marrin të ardhura pa bërë asgjë dhe për këto të ardhura nuk duhet as të paguajnë tatim.

Nisma dëshiron të bëjë ndarje më të drejtë të pasurisë

Nisma donë ta ndryshojë këtë: Të ardhurat kapitale nga një shumë e liru duhet të taksohet më në përqindje më të lartë. Juso propozon një shumë të liru prej



100 000 frangash. Pra, preken vetëm ata që mund të jetojnë me të ardhurat e tyre kapitale.

Të hyrat shtesë nga tatimi prej rreth 10 miliarda frangash do të duhej të lehtësonin punëmarrësit përmes uljeve të tatimit dhe zgjerimit të shërbimeve publike. Për shembull përmes uljes së premive të sigurimeve shëndetësore dhe investimeve nëpër institucione parashkollore (foshnjore), në sistemin shëndetësor dhe komunikacionin publik.

E djathta borgjeze në barrikada

Të djathtët borgjez po përpiqen të pengojnë aprovimin e nismës. Ata pretendojnë, fjala bie, se nisma dëmton ndërmarrjet e vogla dhe të mëdha (NVM): Mirëpo të prekur nga kjo nismë janë personat privat, e jo ndërmarrjet. NVM nuk do taksohen më lartë. Halli për NVM, duket se është vetëm një manovër, për të penguar taksimin më të drejtë të super të pasurve.

Sesioni i grave 2021

Pjesëmarrje edhe e migranteve!

Për të dytën herë në pallatin federal është organizuar një sesion i veçantë për gratë. 246 gra nga të gjitha regjionet e Zvicrës përgjatë dy dytëve do të zënë ulëset në sallën e parlamentit nacional, ku do të diskutojnë preokupimet urgjente të tyre dhe do të trajtojnë parashtrësat nga komisioni i krijuar enkas nga to. Sesioni i parë i grave është zhvilluar me 7 shkurt 1991, në përvjetorin e 700-të të festës federale të Zvicrës.

Marek Wieruszewski



Ne krenohemi veçanërisht që në mesin e grave të përzgjedhura që do të zënë vend në sallën e parlamentit. do të jetë edhe kolegja e jonë e redaksisë Emine Sariaslan. Ne urojmë një sesion produktiv dhe të suksesshëm.

Sesioni i dytë në ndërtesën e parlamentit do të organizohet nga 29 deri më 30 tetor 2021. Në të 246 ulëset e sallës së parlamentit, do të zënë vend gratë nga të gjitha regjionet gjuhësore të vendit. Ato dot ë kenë mundësi që në mënyrë të koncentruar të diskutojnë temat me rëndësi shoqërore-politike. Në përfundim të këtyre dy ditëve do tu dorëzohet një katalog i kërkesave parlamentit dhe qeverisë federale.

Edhe migrantet janë pjesëmarrëse

Për të 200 ulëset janë regjistruar 1400 kandidatë nga moshja 16 vjeç nga e gjithë Zvicra. Të gjitha gratë që jetojnë në Zvicër mund të jenë kandidatë, pavarësisht nga shtetësia apo leja e tyre e qëndrimit. Të 46 ulëset e mbetura do të ndahen në deputetes aktuale të parlamentit. Financimi i këtij manifestimi të madh është siguruar përmes një mbledhje fondesh në internet.

Tetë komisione

Para sesionit gratë do të mblidhen në njërin nga 8 komisionet e parapara, si fjala bie komisioni për të drejtën e votimit për të huajt, apo komisioni për barazi në punë dhe pleqëri, për të përgatitur aty parashtrësata përkatëse. Temat tjera, të cilat do të diskutohen në sesion, janë pajtueshmëria mes profesionit dhe familjes, dhuna ndaj grave, varfëria tek gratë, puna e kujdesit, shëndeti seksual dhe medicina gjinore si dhe çështje tjera të shumta.



Intervista me Steve Pascolo



«Kjo teknologji është një revolucion mjekësor!»

Ka 20 vite që mikrobiologu Steve Pascolo hulumton substancat imune (vaksinat) dhe mRNA- terapitë kundër kancerit. Tani ai punon në Universitetin e Cyrihut dhe bën thirrje për një qendër mRNA për Zvicrën. Teknologjia mRNA paraqet edhe bazën e substancave imune të vaksinave Pfizer/Biontech dhe Moderna kundër Covid-19. Që vetëm brenda një viti të mund të prodhohen substanca të tilla imune, kjo është mundësuar falë kësaj teknologjie.

Steve Pascolo, ju keni bashkë-zhvilluar teknologjinë mRNA, në të cilën bazohen të dy substancat imune të Pfizer/Biontech dhe Moderna, me ndikim të lartë kundër Koronës. Tani këto kanë marr botën. A keni pritur këtë në një kohëzgjatje të tillë?

Unë kam besuar gjithmonë që ne me teknologjinë mRNA mund të ndikojmë shumë. Që nga viti 1998 merrem me këtë çështje si hulumtues. Kjo teknologji është qysh moti e njohur.

Ju thoni, me teknologjinë mRNA njeriu mund të luftojë jo vetëm viruset, porse edhe të shërojë gjithçka, edhe kancerin apo Alzheimerin. Nga vjen ky optimizëm?

Kjo teknologji është një revolucion mjekësor! Është çështje kohe, deri sa të zhvillohen terapi të reja dhe të fillojnë të aplikohen. Studimeve klinike u nevojitet kohë e durim. Mirëpo bazamentet janë këtu. Për çka ne kemi nevojë, janë optimizimet e përhershme për aplikacione shumë të individualizuara. Është koha e fundit që federata të angazhohet në hulumtimin e mRNA-së!

Ju tani punoni në Universitetin e Cyrihut. Çka bëni aty saktësisht?

Unë punoi në klinikën universitare të Cyrihut të institutit dermatologjik dhe zhvilloi substanca specifike imune mRNA. Gjithashtu jam i përfshirë edhe në një projekt me emrin Merit, të iniciuar nga BE dhe të koordinuar nga firma Biontech. Ne zhvillojmë substanca të personalizuar imune mRNA kundër kancerit të gjirit. Pra, substanca imune, të cilat janë përshtatur saktësisht për persona individual, pasi që kanceri tek secili njeri gjithmonë është i ndryshëm.

Tani qeveria federale gjithashtu dëshiron të bëhet pjesë e hulumtimit të mRNA me 50 milion franga. A është kjo një ide e mirë?

Është koha e fundit! Kjo shumë nuk është e madhe, krahasuar me miliardat, të cilat i japin SHBA-të. Bëhet fjalë më pak për para sesa për përvoja e njohuri. Dhe kjo është ajo ku ne jemi në një pozitë të mirë në Zvicër. Unë jam shumë për atë që ne të ndërtojmë një qendër mRNA tek ne. Diskutimet për këtë qendër janë duke u zhvilluar.

Zvicra dikur me Institutin Zviceran të Vaksinimit dhe më vonë me Berna Biotech, ishte udhëheqëse globale në hulumtimin e vaksinave ...

... mjerisht Berna nuk ekziston më! Mirëpo, ato ishin krejtësisht kohë tjera. Një vaksine të bazuar në viruse i nevojiten rreth 6000 litra kultura qelizore, për të prodhuar një milion doza vaksine. Sot në 6 litra mund të prodhohen një milion vaksina mRNA. Biontech dhe Moderna tani kanë Fabrika mRNA, që mund të prodhojnë me miliarda doza vaksinash.

Kjo është çmenduri!

E pra: një revolucion mjekësor!

Megjithatë, shumë njerëz janë skeptikë në lidhje me vaksinimin sepse ata mendojnë se vaksina përmban shumë kimi. A është kjo e vërtetë?

Në vaksinën e re mRNA nuk ka më shumë kimi se sa në një pije të ëmbëlsuar dhe shumë këto i pinë pa mëdyshje. Vaksinat e vjetra gjithashtu përmbajnë materie kimike, fjala bie mjetet e konservimit. Për vaksinën gripale nevojiten shtesë vezësh të miliona pulave. Kjo është ndryshe tek vaksina mRNA e Covid-it, e cila nuk përmban vezë. Është thuaja se vegan.

Ju pyesni, Unia përgjigjet

Jashtë ndërmjetësimit për punë: A kam të drejtë në pension kalimtar?

Kush është në moshën 60 vjeç, nuk ka mund të gjej punë dhe pas 1 janarit 2021 është jashtë ndërmjetësimit për punë, që nga 1 qershori 2021 mund të aplikojë për pension kalimtar. Për të përfituar të drejtën duhet plotësuar shumë kushte.

Kur mund të kem të drejtën për pension kalimtar?

Ju mund të përfitoni nga pensioni kalimtar, nëse ju:

- në rast të jashtë ndërmjetësimit për punë jeni së paku 60 vjeç;
- Së paku 20 vite (nga to pesë pas moshës 50 vjeçare) keni qenë të siguruar në shtyllën e parë AHV/AVS dhe keni arritur të ardhura të caktuara në lartësinë (gjendja me 2021: 21.510 franga);
- Keni vendbanim në Zvicër apo në njërin nga shtetet e BE-së ose EFTA-s;
- Keni një pasuri më pak se 50.000 franga (si person i vetëm) gjegjësisht 100.000 (si çift), me ç' rast nuk do të merret parasysh pronësia në të cilën banoni vet;
- Nuk jeni përfitues pensioni të AHV/AVS apo IV/AI;
- Keni shpenzime të njohura e të pranuar që tejkalojnë të ardhurat tuaja të përlogaritura (parakushti ekonomik)

Sa i lartë është pensioni kalimtar?

Pension kalimtar për personat e vetëm aktualisht është në lartësinë aktuale 44.123 franga në vit, për çiftë janë 66.184 franga. Këtyre u shtohen – sikur tek të përfitimet suplementare – edhe harxhimet e sëmundjes dhe aftësisë kufizuese.

Si përlogaritet pensioni kalimtar vjetor?

Pension kalimtar në parim përlogaritet njëjtë sikur përfitimi suplementar: Kjo korrespondon me diferencën midis shpenzimeve të njohura (harxhimet e përgjithshme të jetesës, shpenzimet për banim, premitë e sigurimeve shëndetësore, etj.) dhe të ardhurave (pagës, pasurisë, fitimi nga pasuria, etj.) të cilat mund të merren parasysh. Detajet për këtë mund ti gjeni në fletëpalosjen "Përfitimet kalimtare për të papunët e shtyrë në moshë". Këto fletëpalosje mund ti merrni tek zyra e kompensimit dhe selitë e saj. Të njëjtën mund ta gjeni edhe në ahv-iv.ch/p/5.03.d.

A më duhet të aplikoi edhe më tej për vend pune?

Si përfitues* e i/e pensionit kalimtar duhet çdo vit të dëshmoni, që përpqeni të integrohni në tregun e punës. Sidoqoftë, përpjekjet për integrim janë shumë të gjera. Krahas aplikimeve të zakonshme për punë gjithashtu njihen e pranohen edhe aktivitetet tjera si përpjekje integruese. Këtu hyjnë fjala bie edhe puna vullnetare, pjesëmarrja në masat integruese, apo kujdesi dhe mbështetja e familjarëve dhe të afërmeve.

Nëse unë kam lehtësira qiraje, a duhet ti lajmëroi për këtë zyrën e kompensimit?

Po, çdo përfitues i pensionit kalimtar -sikur edhe ata të përfitimit suplementar- duhet që çdo ndryshim të marrëdhënieve personale e ekonomike tuajin dhe të personave, të cilët merren parasysh në përlogaritje, menjëherë ta lajmëroi. Këtu hyjnë për shembull ndryshimi i adresës, marrja apo lënia e një vendi pune, marrja e trashëgimisë apo dhurimit. Gjithashtu edhe ndryshimet e qerasë, apo ndryshimi i numrit të personave, të cilët jetojnë në të njëjtën amvisni, duhet të lajmërohen menjëherë.

Kur përfundon e drejta e përfitimit të pensionit kalimtar?

E drejta e përfitimit të pensionit kalimtar përfundon posa të mos ekzistojë njëri nga parakushtet, gjegjësisht posa të është arritur moshë e pensionimit të rregullt. Nëse është e parashikuar se dikush pas pensionimit në moshën e pleqërisë së AHV/AVS do të ketë të drejtë në përfitimet suplementare, e drejta e përfitimit përfundon edhe më herët: gjegjësisht atëherë, kur dikush mund të merr më herët pensionin e pleqërisë.

Ku duhet të aplikoi për pension kalimtar?

Në shumicën e kantoneve mund të shtrohet kërkesa për fitimin e të drejtës së pensionit kalimtar mund të bëhet tek zyra kantonale e kompensimit. Përjashtim: Në kantonin Bazel-qtetet përgjegjës është enti i kontributeve sociale. Në Gjenevë është shërbimi i përfitimeve shtesë, në kantonin e Cyrihut janë qendrat e përfitimeve suplementare të vendbanimeve komunale.

Për informacione të mëtejme shih edhe: www.ahv-iv.ch/de/News-Infos/post/ueberbrueckungsleistungen.

Rezoluta e migrantëve socialdemokrat dhe Partisë Socialdemokrate të Zvicrës

Diaspora me pritshmëri konkrete karshi Zvicrës dhe Kosovës

Ndryshimet politike dhe qeveria e re në Kosovë kanë ngjallur shpresa të mëdha. Ato hapin mundësinë e një nisje gjithëpërfshirëse në këtë shtet të ri me perspektiva të reja sociale, ekonomike, juridike dhe demokratike. Përmes qeverisjes së mirë dhe luftës kundër korrupsionit, ky premtim tani mund dhe duhet të mbahen.



Osman Osmani

Kontributi i diasporës për një zhvillim të qëndrueshëm dhe demokratik të Republikës së Kosovës

Në konferencën e organizuar me 18 qershor 2021 nga migrantët socialdemokrat (PS_Migrant*et) & Partia Socialdemokrate e Zvicrës morën pjesë rreth 60 pjesëmarrës nga Zvicra, Kosova dhe vende tjera të Ballkanit perëndimor. Aty u diskutua se çfarë kontributi mund të jap diaspora për zhvillimin demokratik dhe të qëndrueshëm të Kosovës. Rreth 700.000 qytetarë të Kosovës që jetojnë jashtë vendit janë një potencial i jashtëzakonshëm dhe kanë për të ofruar shumë më tepër se sa remitancat që dërgojnë tek të afërmit te tyre.

Pritshmëritë tona janë:

1. Ne presim nga institucionet e të dyja shteteve tona (Zvicrës dhe Kosovës) që të zhvillojnë politika të diasporës dhe të përpilojnë e zbatojnë plane konkrete për ndërtimin dhe krijimin e mekanizmave dhe strukturave të përbashkëta e të qëndrueshme, të koordinuara në shumë nivele, që duhet të përfshijnë të gjithë aktorët relevantë, veçanërisht personat profesionist (transnacional) dhe rrjetet (shoqatat e grupet tjera të interesit) të diasporës. Në shembullin dhe parimet themelore të integritimit evropian duhet të fuqizohet shkëmbimi dhe të ndërtohet një bashkëpunim koordinues e koherentë. Një politikë e efektshme dhe gjithëpërfshirëse e migracionit dhe zhvillimit duhet të kontribuojë në proceset e afrimit dhe integritimit të Republikës së Kosovës në BE (përfshirë liberalizimin e vizave).

2. Ne presim nga te dyja shtetet që të rinovojnë partneritetin ekzistues të migracionit dhe në këtë kuadër të angazhohen për të përmirësuar situatën sociale, juridike dhe ekonomike të diasporës së Kosovës në Zvicër dhe anasjelltas. Gjegjësisht, Zvicra dhe Kosova duhet të sigurojnë që shtetasit e tyre të mos diskriminohen direkt apo indirekt ose sanksionohen në shtetin partner nëse ata përdorin shërbime shtetërore për të cilat kanë të drejtë. Njerëzit që gjatë tërë jetës së tyre kanë dhënë një kontribut në Zvicër nuk mund të dënohen me përqësimin apo edhe tërheqjen e të drejtës së tyre të qëndrimit nëse ata pretendojnë të drejtën e tyre për mbështetje sociale. Të drejtat e qëndrimit të sigurt janë një nga arritjet më të rëndësishme për pjesëmarrje të drejtë, demokratike dhe të barabartë në shoqëri.

3. Ne presim nga qeveria e re e Kosovës që të përgatitë kornizat juridike dhe institucionale për të mundësuar kontributin efektiv të diasporës për zhvillim demokratik e të qëndrueshëm të Kosovës, përkatësisht

– që sa më shpejtë të krijojë parakushtet për jetësimin e një marrëveshje të partneritetit ekonomik, për të cilën në anën zvicerane tashmë është miratuar mandati negociues bazuar në kriteret e qëndrueshmërisë;

– që të caktoi e dërgoi një atashe sociale e ekonomik, i cili është në dispozicion të diasporës si person kontakti dhe pikë qendrore e kontaktit («single entry point»);

4. Ne presim nga Drejtoria për Zhvillim dhe Bashkëpunim e Zvicrës (DEZA/SDC), që ka përpiluar programin e ri të bashkëpunimit zviceran me Kosovën 2022-2025, të cilin është duke e përpunuar me partnerët lokal në vend, një rëndësi të madhe ti kushtojë përfshirjes së diasporës dhe, së bashku me shoqërinë civile, të mbështet platformat dhe sipas nevojës të ndihmon bashkë-ndërtimin e platformave për rrjetëzimin e potencialit të madh në diasporë dhe që përmes përfshirjes ta bëjë atë fitimprurëse për të gjithë.

5. Ne presim nga të gjithë aktorët politik e shoqëror që përmes mbështetjes dhe përfshirjes së diasporës të kontribuojnë për ndërtimin e sindikatave të pavarura dhe të fuqishme. Vetëm me sindikata të forta dhe shoqata të punëdhënësve të afta për të negociuar, partnerët socialë mund të negociojnë dhe zbatojnë zgjidhje të qëndrueshme e të përgjithshme (kontrata kolektive të punës, marrëveshjet kolektive). Këto krijojnë bazamentin për paga të mira dhe të drejta dhe kushte të mira dhe të sigurta të punës si dhe zhvillimin e një sistemi të fortë të aftësisë profesionale. Pos tjerash ne presim që qeveria e Kosovës të futë pagën minimale, premtim ky i saj në fushatën zgjedhore.

6. Ne presim nga drejtuesit e partive të PS dhe të Vetëvendosjes që bazuar në parimet socialdemokrate në një proces pjesëmarrës të përpunojnë dhe aprovojnë një marrëveshje, e cila rregullon kushtet për bashkëpunim mes partive tona dhe në krahasim me deri më tani të zgjerohet e fuqizohet dukshëm mundësitë e përfshirjes në bashkëbisedim e vendimmarrje të diasporës në grupet e përbashkëta të punës.

7. Ne presim nga diaspora e Zvicrës, e cila ka përbërje të shumëllojshme dhe përfshin njerëz nga të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor e më gjerë, që përmes lidhjeve të tyre familjare dhe një dialogu të intensifikuar të kontribuon në promovimin e paqes dhe demokracisë, kapërcimin e konflikteve ekzistuese dhe promovimin e barazisë midis burrave dhe grave dhe përfshirjen e të gjithëve në një shoqëri që është bërë më e larmishme.